

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Përcaktimi / *el-Tehkik* / التَّحْقِيقُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"أَوْلَمْ تُؤْمِنُ قَالَ بَلَىٰ وَلَٰكِنْ لِيَطْمَئِنَّ قَلْبِي"

“(Allahu) Tha: ‘A nuk po beson?’ Ai (Ibrahimi) tha: ‘Posi, por dua të më kënaqet zemra.’”¹ (el-Bekare, 260)

Përcaktimi² është të kulluarit e dëshirave tua nga i Vërteti, pastaj nëpërmjet të Vërtetit, pastaj në të Vërtetin³. Këta janë emrat e tri niveleve të tij.

Për sa i përket nivelit të parë, kjo ka të bëjë me filtrimin e dëshirave tua nga i Vërteti, dhe kjo është atëherë kur dija jote të mos konkurrojë me të Tijën⁴.

Për sa i përket nivelit të dytë, kjo është atëherë kur të parit tënd të mos konkurrojë me të Tijtë⁵.

¹ Ibrahimi ﷺ asnjëherë nuk dyshoi në fuqinë e Zotit të tij, por deshi që bindja e tij të kalonte nga *ilm el-jekin* (bindja e dijes) në *ajn el-jekin* (bindjen e të parit).

² Kjo është atëherë kur ti përcakton qëndrimin tënd nëpërmjet Allahut dhe e kullon prej mbetjeve të vetvetes që qëndrojnë tek ti, siç është dija jote dhe të parit tënd.

³ Ti përcakton çfarë do nga Allahu, pastaj ti do atë çfarë do nëpërmjet Tij, pastaj ti kupton se nuk ke dashur gjë tjetër përveç Tij.

⁴ Gjithçka që është jotja, do të mohohet. Allahu thotë:

“(Ji i paralajmëruar për) Ditën kur Allahu të tubojë të Dërguarit dhe të thotë: ‘Çfarë përgjigje morët?’ Ata do të thonë: ‘Nuk jemi në dijeni për këtë. Vërtet, Ti je i Dijshmi për të padukshmen’” (el-Ma’ideh, 109). Imam Ibn el-Kajjim përmend në *Medaarixh* se të Dërguarit mohojnë dijen e tyre të përkohshme për të jashtmet, sepse kjo zhduket, kur të krahasohet me dijen përfshirëse dhe të përhershme të Zotit.

⁵ Tash, pas asgjësimit tënd, të parit tënd të Atij, në fakt, është i Tij, kështu që këtë ia atribuon Atij.

Për sa i përket nivelit të tretë, kjo ndodh atëherë kur forma jote (e përkohshme) të mos maskojë përparësinë e Tij. Atëherë, dëshmitë zbehen, shprehjet harxhohen, dhe gjestet zhduken⁶.

⁶ Kur shpirti udhëton mbrapa në kohën kur Allahu ishte dhe asnjë nga këto qenie të tjera nuk ishte.